



REPUBLIKA E S H QIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 1254 prot.

Himarë, më 04.02.2025

**THIRRJE PUBLIKE PËR KËSHILLIN VENDOR TË RINISË
HIMARË**

Bashkia Himarë shpall thirrjen publike për anëtarësim në Këshillin Vendor të Rinisë. Thirrja është e hapur për të gjithë të interesuarit dhe që plotësojnë kriteret. Kandidati/ja duhet të jenë banorë të bashkisë së Himarës dhe të moshës prej 15 deri 29 vjeç.

Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes bëhet nga grupi i punës përgjegjës i ngritur pranë Bashkisë Himarë duke u bazuar në kriteret dhe procedurat që parashikon ligji.

Kandidatët përfaqësues të organizatave rinore ose të rinjtë, duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

1. të jenë përfaqësues të një organizate rinore ose për të rinjtë;
2. të mos jetë i dënuar;
3. të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
4. të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit të KVR;

Kandidatët për KVR, përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë duhet të paraqesin interesin e tyre, në adresën e e-mailit: info@himara.gov.al, ose pranë zyrës së informacionit të Bashkisë Himarë, **brenda afatit 25.02.2025** duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

1. kërkesë me shkrim ku të shprehë interesin dhe motivimin për aplikim;
2. jetëshkrim;
3. fotokopje të dokumenteve që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
4. vërtetim të gjendjes gjyqësore;
5. vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;
6. referenca nga të paktën 2 bashkëpunëtorë të mëparshëm;

Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve.

Njoftimi i fituesëve do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

ME DELGIM DHE ME URDHER
ZEVENDESKRYETARI
Pervin Gjiguria

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

